



## **K O N K U R S**

### **Për vend të lirë pune:**

Pozita: **Shofer (Vozitës)**  
Vendi i punës: **Ambasada e Republikës së Kosovës në Berlin**  
Kohëzgjatja e kontratës: **Një vit (me mundësi vazhdimi) me një periudhë provuese prej 3 muajsh**  
Data e aplikimit: **(22.8.2022-5.9.2022)**

### **Detyrat dhe Përgjegjësitë**

Nën mbikëqyrjen dhe përgjegjësin e Shefit të misionit, kryen detyrat dhe përgjegjësit si më poshtë:

- Ofron shërbime të vozitjes për shefin e misionit, zyrtarin e lartë diplomatik ose personelin tjetër konsullor sipas kërkesës;
- Vozitësi duhet të jetë në gjendje që të kryen riparime të vogla dhe siguron që automjeti të jetë i pastër dhe në gjendje të mirë;
- Duhet të jetë në gjendje që menjëherë pas thirrjes nga shefi i misionit ose zyrtari të lartë diplomatik të ofrojë mbështetje për vozitje për detyra zyrtare në mbrëmje ose gjatë fundjavës;
- Duhet të jetë në dispozicion për vizita zyrtare;
- Kryerja e funksioneve rutinore të postës dhe korrierit, shpërndarja dhe regjistrimi i postës konsullore, transportit të mallrave dhe ngarkesa të tjera;
- Prokurimi i pajisjeve dhe furnizimeve për ambasadë, konsullatë ose rezidencën zyrtare;
- Mbajtja e librit të shënimeve për kilometrazhin e automjeteve, të riparimeve, licencave dhe lejeve, si dhe dokumentacioneve të tjera;
- Është përgjegjës për dëmet e shkaktuara në automjet nga pakujdesia apo mospërshtatja e kushteve të komunikacionit;
- Sigurohet që të gjitha veprimet të jenë në pajtim me rregullat dhe rregulloret në rastin e përfshirjes në aksident/incident trafik;u;
- Kryerja e detyrave të tjera zakonisht të caktuara për Vozitësin.

### **Kriteret dhe kushtet e nevojshme**

- Kandidati duhet ta ketë të kryer shkollën e mesme përkatëse ose ekuivalente;
- Te jetë shtetas/e i Republikës së Kosovës (me qëndrim të rregulluar në shtetin pranues), shtetas/e i/e shtetit pranues apo shtetas/e i/e vendit të tretë;
- Kandidati duhet të ketë patentë shoferi valid (të vlefshëm) të lejuar në shtetin pranues;
- Të ketë së paku 3 vjet përvojë si vozitës;
- Kandidati duhet të jetë në gjendje të punojë nën presion, të ketë etikë në punë dhe integritet të lartë pune;
- Kandidati duhet të jetë në gjendje të punojë me orar fleksibil të punës;
- Kërkohej njohja e gjuhës së vendit ku shërben, ndërsa njohja e gjuhëve tjera është përparësi.

### **Kandidatët të cilët aplikojnë duhet ti plotësojnë këto kushte, për të hyrë në rrethin e ngushtë dhe pastaj për të intervistuar.**

- CV-në;
- Kopjen e patentë shoferit dhe letërnjoftimit;
- Kopjet e kualifikimit-diplomës;
- Dy referenca të punës dhe një letër motivuese;
- Çertifikatën nga mjeku për gjendjen shëndetësore;
- Çertifikatën se nuk janë nën hetime nga autoritetet e shtetit pranues;

Këto dokumente mund të dërgohen përmes postes ne adresën Botschaft der Republik Kosovo „Koenigsallee 20A/20B, 14193 Berlin“ ose përmes e-mailit [embassy.germany@rks-gov.net](mailto:embassy.germany@rks-gov.net)

Dokumentet i dërgoni fotokopje sepse të njëjtat nuk kthehen.